Numër: 01-978 Datë: 13.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Rregulloren e Monitorimit Nr. 01/2026 për kriteret dhe procedurat për monitorimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026 merr:

**V E N D I M**

I. **Tërhiqet akreditimi** i Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K., me seli në rrugën "Ukë Bytyqi", në Prizren, i dhënë me Vendimin nr. 01-462, të datës 29.05.2026, për kualifikimet e validuara:

i. **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë** – Niveli III dhe IV i KKK-së, me 180 kredi të AAP-së; dhe
ii. **Teknik i Laboratorit Mjekësor** - Niveli III dhe IV i KKK-së, me 180 kredi të AAP-së.

I. Nga marrja e këtij vendimi ndalohet regjistrimi i nxënësve në këto kualifikime.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Bazuar në monitorimin e realizuar më 31.08.2026 në Kolegjin Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K., në Prizren, në përputhje me Rregulloren Nr. 01/2026 për kriteret dhe procedurat për monitorimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës, si dhe në shqyrtimin e raporteve të akreditimit dhe validimit, dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, sqarimeve të menaxhmentit dhe gjetjeve të evidentuara gjatë vizitës në terren, janë konstatuar ndryshime të rëndësishme në kushtet infrastrukturore mbi bazën e të cilave është dhënë akreditimi për kualifikimet "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë" dhe "Teknik i Laboratorit Mjekësor".

Institucioni UBT në Prizren është akredituar nga AKK-ja me Vendimin nr.01-462, të datës 29.05.2026, për ofrimin e kualifikimeve përkatëse, me kapacitet deri në katër klasa në vit, respektivisht 100 kandidatë. Mirëpo gjatë procesit të monitorimit është konstatuar se pas procesit të riakreditimit dhe rivalidimit, institucioni ka riorganizuar hapësirat e objektit për ndarjen e hapësirave të arsimit të lartë nga ato të arsimit parauniversitar, si pasojë e kërkesave të ndërlidhura me procesin e rilicencimit të shkollës. Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të raporteve të akreditimit dhe validimit, vizitës në terren të datës 31.08.2026, dokumentacionit shtesë të paraqitur nga institucioni dhe sqarimeve të dhëna nga menaxhmenti, ka konstatuar se UBT në Prizren ka ndërmarrë veprime për zbatimin e shumicës së rekomandimeve të mëparshme.

Megjithatë, riorganizimi i hapësirave ka krijuar një gjendje të ndryshme nga ajo e vlerësuar gjatë procesit të akreditimit dhe validimit, duke ndikuar në përmbushjen e kritereve infrastrukturore dhe në mundësinë e realizimit të procesit mësimor për kapacitetin e lejuar prej 100 kandidatëve në vit.

**Për kualifikimin "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë"**, monitorimi ka evidentuar se ndryshimi i hapësirave ndikon në përmbushjen e kritereve infrastrukturore të përcaktuara në raportet e

akreditimit dhe validimit. Institucioni ka deklaruar se nuk planifikon regjistrimin e kandidatëve në këtë kualifikim gjatë vitit shkollor përkatës, me qëllim të përgatitjes dhe përshtatjes së kushteve të nevojshme. Megjithatë, mosregjistrimi i përkohshëm i kandidatëve nuk e eliminon detyrimin e institucionit për të përmbushur kriteret dhe standardet mbi bazën e të cilave është akredituar.

**Për kualifikimin "Teknik i Laboratorit Mjekësor"**, gjatë monitorimit është konstatuar se laboratori është identifikuar dhe vendosur në hapësirat e riorganizuara. Megjithatë, janë evidentuar ende çështje që kërkojnë përmirësim, përfshirë vendosjen e shenjave informuese dhe paralajmëruese të sigurisë, ventilimin dhe aspekte të tjera të funksionalitetit të laboratorit. Institucioni ka deklaruar se është duke ndërmarrë veprime për përmirësimin e kushteve dhe për zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve, por në kohën e monitorimit nuk është dëshmuar përmbushja e plotë e të gjitha kushteve të nevojshme.

Po ashtu, është konstatuar se institucioni nuk e kishte njoftuar AKK-në paraprakisht për ndryshimin e hapësirave, ndonëse njoftimi për ndryshimet që mund të ndikojnë në përmbushjen e kritereve të akreditimit është obligim ligjor i përcaktuar me ligj dhe me Rregulloren e Monitorimit Nr.01/2026. Ky veprim ka penguar vlerësimin paraprak të ndikimit të ndryshimeve infrastrukturore në kushtet dhe kapacitetet e miratuara.

Këshilli Drejtues duke vlerësuar në mënyrë të ndërlidhur gjetjet e monitorimit, ndryshimin e konsiderueshëm të hapësirave, ndikimin e drejtpërdrejtë të këtij ndryshimi në kapacitetin e lejuar të kandidatëve, mangësitë e evidentuara në kushtet e laboratorit për kualifikimin "Teknik i Laboratorit Mjekësor" dhe mosnjoftimin paraprak të AKK-së për ndryshimet e bëra, vlerëson se institucioni nuk dëshmon përmbushjen e vazhdueshme të kushteve dhe standardeve mbi bazën e të cilave është akredituar për të dy kualifikimet. Tutje KD i AKK-së duke ju referuar rrethanave faktike dhe juridike, raporteve të lartëcekura të monitorimit dhe inspektimit, ka konstatuar se bazuar në të dhënat e referuara në këto raporte Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" me seli në rrugën "Ukë Bytyqi", në Prizren, ka shkelur kushtet e akreditimit/validimit dhe është konstatuar papajtueshmëri të përcaktuara me nenet 17 dhe 18 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare.

Rrjedhimisht bazuar edhe në kompetencat ligjore vendosi që të aplikoj dispozitën e nenit 19 të këtij ligji dhe dispozitat e nenit 23 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime, si dhe nenit 15 [par. 3 dhe 4] të Rregullores së Monitorimit Nr. 01/2026, duke tërhequr akreditimin për kualifikimet "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë" dhe "Teknik i Laboratorit Mjekësor", në Kolegjin Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" duke vendosur si në dispozitiv.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë për rishqyrtim të vendimit, sipas nenit 20, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa i dorëzohet Këshillit Drejtues të AKK-së brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.*

**Vendimi u dërgohet:**

- Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K., Prizren;
- Arkivit të AKK-së.
- MASh

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve